



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 521/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "SigKos" sh.a.- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i automjeteve zyrtare të Institucioneve komunale" me nr. prokurimi 615-19-3324-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Podujevës, më datë: 11.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "SigKos" sh.a.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i automjeteve zyrtare të Institucioneve komunale" me nr. prokurimi 615-19-3324-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues -Komuna e Podujevës.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Sigurimi i automjeteve zyrtare të Institucioneve komunale" me nr. prokurimi 615-19-3324-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Podujevës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e "SigKos" sh.a.- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar të njëjtës i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 21.05.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 11.06.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 05.08.2019.

Letra standarde për Operoret Ekonomik si tenderues të eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 07.08.2019.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatori ekonomik, me dt: 09.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 13.08.2019, Autoriteti kontraktues, ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "SigKos" sh.a.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.08.2019, me nr. 521/19, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: "Sigurimi i automjeteve zyrtare të Institucioneve komunale" me nr. prokurimi 615-19-3324-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Podujevës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 22.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 30.08.2019, sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE "Sigkos" Sh.a, se AK nuk e ka ftuar të nënshkruaj kontratën edhe pse AK me datë 10.07.2019, përmes letrës standarde për tenderuesin e suksesshëm (B45) e ka njoftuar OE "Sigkos"Sh.a,se i është dhënë kontrata me çmim më të ulët në vlerë prej 10,181.64 € në pajtim me afatet dhe kushtet e Dosjes së tenderit, me ç'rast AK ka bërë shkelje të nenit 26 të LPP-së "Nënshkrimi i kontratave publike", eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK me datë 10.07.2019 përmes letrave standarde tenderues të eliminuar,tenderues të pasuksesshëm dhe tenderues i suksesshëm ka njoftuar se oferta e OE "Sigkos" është përzgjedhur për dhënie të kontratës me çmim më të ulët (10,181.64 €).

Në letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm (B45) thuhet që dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadim të intervalit gjatë të cilit tenderuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Bazuar në nenin 26 pika 4.1 të LPP-së, AK mund të nënshkruaj kontratën kur kanë kaluar së paku 10 ditë nga data e njoftimit për dhënien e kontratës (nëse gjatë këtij intervali nuk ka pas ndonjë kërkesë për rishqyrtim nga OE tjerë pjesëmarrës).

Me datë 12.07.2019 OE "Sigal Uniqa Group Austria" Sh.a (brenda afatit 5 ditor) parashtron kërkesë për rishqyrtim të vendimit të datës 10.07.2019, pranë AK me pretendimin se OE i propozuar për kontratë (Sigkos) ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm sepse oferta e tyre është për 45 automjete e jo për 51 siç është kërkuar me datë 31.05.2019 përmes njoftimit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

AK me date 15.07.2019 miraton si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE "SigalUniqa Group Austria" dhe vendos që aktiviteti i prokurimit të kthehet në procedurë të rivlerësimit.

Me datë 05.08.2019 komisioni i vlerësimit të tenderëve gjatë procedurës së rivlerësimit konstaton se oferta OE "Sigkos"Sh.ae propozuar fituese me datë 10.07.2019 shpallet e papërgjegjshme me arsyetimin se ka dorëzuar specifikacion të pavlefshëm duke ofertuar me specifikacionin e vjetër për 45 automjete dhe jo me specifikacionin e ri për 51 automjete siç është kërkuar me datë 31.05.2019 përmes njoftimit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Komisioni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit e rekomandon për kontratë tenderin e dorëzuar nga OE "Sigal Uniqa Group Austria" me çmim 10,856.60 €.

Konsideroj që AK ka respektuar nenin 26 të LPP-së,lidhur me afatet e nënshkrimit të kontratës dhe afatet për parashtrimin e kërkesave për rishqyrtim dhe pretendimi i OE ankues se është shkelur neni 26 i LPP-së, është i pabazuar.

OE ankues "Sigkos" sh.a, në kërkesën për rishqyrtim pranë AK dhe në ankesën në OSHP nuk pretendon se oferta e tyre është shpallur pa të drejtë e papërgjegjshme, por vetëm kërkon që njoftimi për dhënie të kontratës i datës 10.07.2019 të zbatohet, përkundër asaj që ka pasur kërkesë për rishqyrtim dy ditë pas njoftimit për dhënie të kontratës.

Me datë 12.07.2019 në sistemin e-prokurimi është ngarkuar kërkesa për rishqyrtim nga ana e OE "Sigal Uniq Group Austria" dhe OE i propozuar për kontratë "Sigkos" sh.a, ka pasur qasje në e-prokurim për këtë aktivitet të prokurimit dhe në bazë të Ligjit të LPP-se, nenit 26 dhe nenit 108/A, AK është i obliguar të respektoj të gjitha të drejtat dhe afatet që dalin nga këto dy nene për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim brenda afatit (brenda 5 ditëve pas njoftimit për dhënie të kontratës) e obligon AK që të pezulloj nënshkrimin e kontratës deri në procesin përfundimtar të ankesave, përfshirë këtu edhe ankesën e mundshme në OSHP. Të gjitha veprimet e AK janë konform nenit 26 dhe 108/A të ligjit të LPP-së. Pretendimi i OE ankues është i pabazuar

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet për arsyet që i theksuam në përgjigjeje të pretendimit ankimor të më sipërm. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me lidhjen e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i automjeteve zyrtare të Institucioneve komunale" me nr. prokurimi 615-19-3324-2-2-1 të iniciuar nga AK-"Komuna e Podujevës"

Operatori Ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.08.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues, përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.08.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 11.09.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e AK-së, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues nuk është prezent në seance edhe pse i njëjti ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt por i njëjti nuk na ka njoftuar për arsyen e mos pjesëmarrjes në këtë seance, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e

komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Shala deklaroj: Sipas dispozitave të nenit 26 të LPP-së, OE "SigKos" që sipas LPP-së ka pritur sipas afatit kohor dhe të gjitha kushteve ka pritur përgjigjen nga Autoriteti Kontraktues për të nënshkruar kontratën. Me datë 10.07.2019 jemi njoftuar nga Autoriteti Kontraktues për njoftim kontrate deri me datën 07.08.2019 deri sa u njoftua për here të dyte OE fitues po të njëjtin tender nuk kemi marr nga Autoriteti Kontraktues asnjë përgjigje mbi pezullimin e AP – të dhënies së kontratës mbi refuzimin e kërkesës së OE e cila është obligative sipas LPP-së dhe afateve kohore sipas nenit 26. Mbas 12 ditësh mbasi jemi njoftuar me kontrate zyrtarja e lartë e prokurimit në Autoriteti Kontraktues znj. Ganimete Mehmeti na merr në tel në zyrë të Kompanisë "SigKos" që ti sjellim 3 dokumentet që kërkohen nga Autoriteti Kontraktues Polisen e Sigurimit, Vërtetimin e ATK-së, po ashtu edhe të Gjykatës Themelore. Këtë e ka kërkuar znj. Ganimete Mehmeti, ndërsa ne kemi qenë obligativ të dorëzojmë po të njëjtën ditë sipas kërkesës së tyre, arsyeja të cilën e ankesës që ju kemi drejtuar OSHP-së është që ne kemi pritur sipas afateve kohore vetëm për nënshkrim të kontratës të cilat janë përmbushur sipas ligjit në fuqi. Ndërsa me datë 07.08.2019+ na vjen njoftimi për dhënie të kontratës OE SIGAL për të njëjtin titull sipas zyrës ligjore që kemi në si kompani "SigKos" dhe 14 vite që operojmë si kompani është hera e parë të shpallen për një dosje të tenderit 2 OE për të njëjtin titull.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Fejza deklaroj: Autoriteti Kontraktues kemi vendimin dhe do të ju dorëzojmë si prova që lënda është kthyer në rivlerësim në ankesën e OE Sigal, kemi caktuar komisionin e rivlerësimit dhe Komisioni na ka rekomanduar sepse është bërë gabim specifikacionin dhe kemi korrigjuar gabimin në afat ligjor është dorëzuar 51 është kërkuar 45, të gjithë OE-te e kanë pranuar, OE ankues kur ka pas kërkesë në dokumentacion ka thënë se e kam dorëzuar një javë përpara sepse kemi me shkuar në pushim. Ne kemi pranuar dhe jemi pran vendimit tonë dhe pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti profesional i prokurimit z. Papaj deklaroj: Me datën 10.07.2019, Autoriteti Kontraktues, njofton për dhënie të kontratës SIGOS në beteren standarde B45 thotë nuk përben marrëveshje kontraktuale deri në përfundimin e afatit të ankesave të mundshme. OE Sigal paraqet kërkesë për rishqyrtim në Autoriteti Kontraktues dhe është në e-prokurim, është e vërtetë OE ankues nuk pretendon se është shpallur e përgjegjshme oferta e tyre, për makina është 45. Në kërkesën e rivlerësimit kanë

konstatuar se OE "SigKos" është e papërgjegjshme, AK përmes korrigjimit e ka ngrit ne sistem dhe asnjë OE nuk ka pasur problem.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Shala deklaroj: Propozojmë qe ankesa jone te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Fejza deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te refuzon ankesën e OE si te pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se lidhur me pretendimin e OE "Sigkos" Sh.a, se AK nuk e ka ftuar të nënshkruaj kontratën edhe pse me datë 10.07.2019, për mes letrës standarde për tenderuesin e suksesshëm (B45) e ka njoftuar OE "Sigkos"Sh.a, se i është dhënë kontrata me çmim më të ulët në vlerë prej 10,181.64 € në pajtim me afatet dhe kushtet e Dosjes së tenderit, me ç'rast AK ka bërë shkelje të nenit 26 të LPP-së "Nënshkrimi i kontratave publike", paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues profesional të dhënë në ekspertizë konstaton se AK me datë 10.07.2019 përmes letrave standarde tenderues i suksesshëm ka njoftuar se oferta e OE "Sigkos" është për zgjedhur për dhënie të kontratës më çmim më të ulët (10,181.64 €). Në letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm (B45) thuhet që dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadim të intervalit gjatë të cilit tenderuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Bazuar në nenin 26 pika 4.1 të LPP-së, AK mund të nënshkruaj kontratën kur kanë kaluar së paku 10 ditë nga data e njoftimit për dhënien e kontratës (nëse gjatë këtij intervali nuk ka pas ndonjë kërkesë për rishqyrtim nga OE tjerë pjesëmarrës).

Me datë 12.07.2019 OE "Sigal Uniq Group Austria" Sh.a (brenda afatit 5 ditor) parashton kërkesë për rishqyrtim të vendimit të datës 10.07.2019, pranë AK me pretendimin se OE i propozuar për kontratë (Sigkos) ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm sepse oferta e tyre është për 45 automjete e jo për 51 siç është kërkuar me datë 31.05.2019 përmes njoftimit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara. AK me date 15.07.2019 miraton si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE "Sigal Uniq Group Austria" dhe vendos që aktiviteti i prokurimit të kthehet në procedurë të rivlerësimit.

Me datë 05.08.2019 komisioni i vlerësimit të tenderëve gjatë procedurës së rivlerësimit konstaton se oferta OE "Sigkos" sh.a e propozuar fituese me datë 10.07.2019 shpallet e papërgjegjshme me arsyetimin

se ka dorëzuar specifikacion të pavlefshëm duke ofertuar me specifikacionin e vjetër për 45 automjete dhe jo me specifikacionin e ri për 51 automjete siç është kërkuar me datë 31.05.2019 përmes njoftimit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Komisioni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit e rekomandon për kontratë tenderin e dorëzuar nga OE "Sigal Uniqa Group Austria" me çmim 10,856.60 €.

Duke u bazuar në procedurën e zhvilluar nga AK paneli shqyrtues vlerëson se AK ka respektuar nenin 26 të LPP-së, lidhur me afatet e nënshkrimit të kontratës dhe afatet për parashtrimin e kërkesave për rishqyrtim dhe pretendimi i OE ankues se është shkelur neni 26 i LPP-së, është i pabazuar.

OE ankues "Sigkos" sh.a, në kërkesën për rishqyrtim pranë AK dhe në ankesën në OSHP nuk pretendon se oferta e tyre është shpallur pa të drejtë e përgjegjshme, por vetëm kërkon që njoftimi për dhënie të kontratës i datës 10.07.2019 të zbatohet, përkundër asaj që ka pasur kërkesë për rishqyrtim dy ditë pas njoftimit për dhënie të kontratës.

Me datë 12.07.2019 në sistemin e-prokurimi është ngarkuar kërkesa për rishqyrtim nga ana e OE "Sigal Uniqa Group Austria" dhe OE i propozuar për kontratë "Sigkos" sh.a, ka pasur qasje në e-prokurim për këtë aktivitet të prokurimit dhe në bazë të Ligjit të LPP-se, nenit 26 dhe nenit 108/A, AK është i obliguar të respektoj të gjitha të drejtat dhe afatet që dalin nga këto dy nene për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim brenda afatit (brenda 5 ditëve pas njoftimit për dhënie të kontratës) e obligon AK që të pezulloj nënshkrimin e kontratës deri në procesin përfundimtar të ankesave, përfshirë këtu edhe ankesën e mundshme në OSHP. Paneli shqyrtues vlerëson se të gjitha veprimet e AK janë konform nenit 26 dhe 108/A të ligjit të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - Komuna e Podujevës,

1x1 OE - "SigKos" sh.a,-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI